

371
28.02.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1186/3 Prot.

Tiranë, më 25.2. 2022

URDHËR

Nr. 98, Datë 25.2.2022

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË
DOKTORATË NË “AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI”, NË UNIVERSITETIN
E SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 77 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin për shkak të ligjit të programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” që do të zhvillohet në gjuhën shqipe.
Studimet e doktoratës të zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë/ve bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor” në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Aktivizimi i programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, fillon brenda njëzet e katër muajve, në bazë të legjislacionit në fuqi.
3. Universiteti i Sporteve të Tiranës të respektojë kriteret për personelin akademik të angazhuar për programin e studimit, lidhur me numrin maksimal të udhëheqjeve që mund të kenë në të gjitha IAL-të, në varësi të titullit akademik që zotëron udhëheqësi, në bazë të legjislacionit në fuqi.

4. Universiteti i Sporteve të Tiranës të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i Sporteve të Tiranës të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Universiteti i Sporteve të Tiranës të ndjekë procedurat për regjistrimin e gradës shkencore "Doktor" në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë, pranë strukturës përgjegjëse kompetente.
7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Agjencia e Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

